

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **Nr. i AP: KEK-25-5008-2-1-1**

Sa i përket tenderit për : **Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës në KEK sh.a.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

MD Legal Consulting & Training Center SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

(Adresa)

Rruga Bedri Shala, 101-9 Lagja e Muhagjerve Prishtinë , 10 000

(Vendi)

(Kodi postar)

+38344827079

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Naim Restelica

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

legalcon.md@gmail.com

(Adresa elektronike)

04.08.2025

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Autoriteti kontraktues ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull: "Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës në KEK sh.a", Nr. i prokurimit: KEK-25-5008-2-1-1 dhe Nr. i brendshëm KEK-25-106-211. Ankusi në cilësi të palës me interes operatorëve ekonomik, brenda afatit të përcaktuar ka përgatitur dhe dorëzuar ofertën e vet për këtë aktivitet të prokurimit. Me datën 04.06.2025 është parashikuar të bëhet hapja e ofertave dhe leximi i çmimeve.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me datë 11.07.2025 kemi parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim
Me datë 16.07.2025 ka nxerruar vendim për refuzim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1
Neni 6
Neni 27
Neni 28
Neni 68
Neni 69

** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkëlqjen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në shqyrtimin e dosjes së tenderit dhe njoftimit përkatës, kemi evidentuar disa kërkesa që, sipas vlerësimit tonë të argumentuar, janë të karakterit diskriminues dhe favorizues ndaj operatorëve të caktuar ekonomikë. Këto elemente përbëjnë devijim nga parimet themelore të barazisë në trajtim dhe konkurrencës së ndershme të garantuara me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), konkretisht në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 27 të tij. Prandaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që t'i trajtojë me kujdes dhe paanshmëri këto çështje, në mënyrë që të sigurohet respektimi i parimeve ligjore dhe të shmangen praktikatat që mund të dëmtojnë integritetin dhe besueshmërinë e procesit të prokurimit publik.: Ju kini dhënë një sqarim, por sikurse edhe ne nuk ju kemi thënë që ka profesion Universitar deficit, por kemi certifikim deficitar nga MPMS/MFPT dhe Licencë të VNM, andaj kërkojmë që të merren përbazë kërkesat duke ruajtur prestigjin e departamentit të prokurimit si Autoritet të besueshëm dhe parimor, andaj kërkojmë gjithashtu shqyrtim:

- 1. Pika 9.1 & 9.2 – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Pika 2.6: Një Ekspert i Inxhinierisë Ekonomike Dëshmia e kërkuar dokumentare:** Të ofrohet si dëshmi diploma universitare (kopje), kontrata e punës ose marrëveshjet për projektin konkret dhe certifikata nga MPMS. Me 5 vite përvojë pune, të dëshmohet me referenca.

Vlerësimi dhe rekomandimi ynë për këtë kriter/kërkesë: Si e tillë, kjo kërkesë është shumë kufizuese, ku bazuar në informatat nga qendrat e trajnimit dhe listave zyrtare për persona të certifikuar nga MFPT respektivisht komisioni për certifikim nga kjo ministri kemi vetëm një person të certifikuar si ekspert i SSHP-së dhe ky person është në njërin nga kompanitë e licencuara dhe

pretenduese për aplikim si operator ekonomik, dhe gjithashtu në gjithë Kosovën është vetëm një Ekspert të Inxhinierisë Ekonomike. Ky kriter cenon konkurrencën, duke përjashtuar operatorë të kualifikuar, të cilët kanë në dispozicion ekspertë të certifikuar në fushën përkatëse, por jo një profil të tillë të rrallë dhe të papërfaqësuar gjerësisht në tregun vendor. Ky kriter/kërkesë është në kundërshtim me **Nenin 7 – Trajtim i barabartë/Jo-diskriminim** të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, sepse është diskriminues. Nuk përkon me natyrën teknike të shërbimit, i cili kërkon njohuri profesionale nga fusha e shëndetit dhe sigurisë në punë, Shkencat teknike të inxhinierisë së ndërtimit/mjedisit apo certifikimeve të sigurisë, dhe jo nga inxhinieria ekonomike.

SEPSE

Duke marrë parasysh që objekti i kontratës ka të bëjë me vlerësimin e rrezikut në vendin e punës, konsiderojmë se ky kriter:

- Nuk përkon me natyrën teknike të shërbimit, i cili kërkon njohuri profesionale nga fusha e shëndetit dhe sigurisë në punë, inxhinierisë së ndërtimit/mjedisit apo të certifikimeve të sigurisë, dhe jo nga inxhinieria ekonomike;
- Është joproporcional dhe i panevojshëm, pasi nuk kontribuon drejtpërdrejt në

realizimin cilësor të detyrave të kontratës;

- Bie ndesh me parimet e proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të përcaktuara në Nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Për këto arsye, kërkojmë rishikimin dhe largimin e këtij kriteri nga dokumentacioni i tenderit dhe zëvendësimin e tij me kriterë më përkatëse për natyrën e kontratës, si p.sh. **ekspert i certifikuar në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë**. Nga të cekurat më lart, vlerësojmë se kriteri/kërkesa e lartcekur ul në maksimum konkurrencën dhe si e tillë është në kundërshtim me LPP – prandaj i propozojmë autoritetit kontraktues që kjo kërkesë të ndryshohet dhe të vendoset si më poshtë:

Pika 2.6: Ekonomist, i certifikuar nga MPMS/MFPT me përvojë relevante në menaxhimin ekonomik të projekteve të ngjashme. **Dëshmia e kërkuar dokumentare:** Të ofrohet si dëshmi diploma universitare (kopje), kontrata e punës ose marrëveshjet për projektin konkret dhe certifikata nga MPMS. Me 5 vite përvojë pune, të dëshmohet me referenca.

2. Pika 9.1 & 9.2 – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Pika 2.7: Një (1) Ekspert I Biologjisë – Drejtimi: Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit Dëshmitë e kërkuara: Të ofrohet si dëshmi diploma universitare (kopje), kontrata e punës ose marrëveshjet për projektin konkret dhe certifikata nga MPMS, si dhe licenca për VNM nga institucioni kompetent, me 5 vite përvojë pune, të dëshmohet me referenca.

Bazuar në hulumtimet e tregut komunikimeve me autoritetet përkatëse të certifikimit të personave për Ekspert të SSHP-së dhe Licencuar për VNM. Konsiderojmë se kërkesa është diskriminuuese, ngase nëse i referohemi institucioneve kompetente për licencimin e personave sipas kësaj kërkesë, rezulton se në Kosovë janë vetëm tre persona të certifikuar nga MPMS/MFPT dhe të Licencuar për VNM janë 2 persona,

ku sipas informacioneve që ne posedojmë, vetëm një është i certifikuar në dy lëmit, i cili është punësuar në të një kompani pretenduese për pjesëmarrje në këtë aktivitet.

Edhe përkundër faktit se kërkesa si e tillë e bën kriterin kufizues dhe joproportional, kërkohet një ekspert me profil shumë specifik: Biologji – drejtimi Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit. Ky kombinim i certifikimit me këtë profesion është jashtëzakonisht i rrallë në tregun e punës në Kosovë, sepse:

- Nuk përfaqëson një drejtim standard që ofrohet në mënyrë të rregullt nga universitetet në atë aspekt që të kemi certifikime nga ana e SSHP-së dhe VNM mjaftueshëm për tregun;
- Ndërthurja e **Biologjisë** me specifika nga **Ekologjia dhe mbrojtja e mjedisit** me këtë drejtim është jo e zakonshme në nivel profesional ose akademik.

Ky formulim përjashton ekspertët që kanë kualifikime të krahasueshme ose më të larta, por me tituj pak më të ndryshëm (p.sh., Biologji / Biolog etj.).

Kërkesa si e tillë, së bashku me dëshmitë e kërkuara:

- Kufizon padrejtësisht konkurrencën – cenon parimin e trajtimit të barabartë (Neni 7 i LPP-së);
- Vetëm një numër shumë i kufizuar individësh mund të përmbushin të gjitha elementet: drejtimi specifik, licencë për VNM, kontratë pune, certifikatë MPMS dhe përvojë 5-vjeçare.
- Projekti i referohet Vlerësimin të riskut në vende pune dhe është relevante me certifikimin e Eksperteve nga MFPT/MPMS dhe Certifikimi për Vlerësimin e

Ndikimit në Mjedis-VNM e jap Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e cila edhe ligjërisht nuk ka të bëjë me këtë projekt. Vlenë të theksohet së AK – KEK, ka realizuar tashme Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe e posedon mendimin profesional nga aktiviteti paraprak i prokurimit për VNM sipas kërkesave ligjore në vend.

Përveç tjerash Ekspert i certifikuar për SSHP nga MFPT në Drejtimin e Biologjisë e përfaqëson plotësisht këtë kriter, pasi që Ekologjia dhe mbrojtja e mjedisit është degë e Biologjisë.

Konsiderojmë se AK është e obliguar që të hapë tregun për ekspertë realisht kompetentë për **Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM)**. Ky kriter favorizon operatorë të caktuar, duke shkelur konkurrencën dhe barazinë ndërmjet OE-ve.

Aktualisht në Kosovë sipas listave zyrtare pranë Komisionit për certifikim të Ekspertve të SSHP-së dhe Lista zyrtare e të Licencuarve për VNM janë:

- Tre (3) persona të certifikuar si Ekspert në Drejtimin e **Biologjisë** me Dega **Ekologjia dhe mbrojtja e mjedisit dhe**
- **Dy (2) Persona të Licencuar pran MMPHI për VNM**

Vërejtje: Nga këta persona vetëm një posedon certifikim për Ekspert të SSHP dhe VNM.

Dëshmitë e specifikuar në këtë kërkesë përbëjnë një barrë disproporcionale dhe duhet të ndryshohen.

Propozimi ynë për pikën 2.7 është si vijon: Biolog i certifikuar nga MPMS, pa licencë specifike për VNM, por me përvojë relevante, nisur edhe nga fakti se vetë AK ka kërkuar edhe 3 pozita të tjera me licencë për VNM, ku ka mbulueshmëri të mjaftueshme, kur dihet që tenderi ka të bëjë me **vlerësim të rrezikut për vendet e punës** dhe nuk është kërkuar **Vlerësim i Ndikimit në Mjedis**. **Apo pranueshmerinë e një Biologu – Ekspert për SSHP dhe një Biolog i Licencuar për VNM.**

3. Pika 9.1 & 9.2 – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Pika 2.20: Një Inxhinier i diplomuar i Gjeologjisë;

Dëshmitë:Diplomë, kontratë, certifikatë nga MPMS dhe licencë për VNM, me 5 vite përvojë pune.Edhe kjo kërkesë është diskriminuese, sepse ky profil i inxhinierëve është deficit në Kosovë. Sipas të dhënave që kompania jonë posedon, rezulton se vetëm një person në Kosovë është i certifikuar nga MPMS dhe për VNM. Kjo mund të vërtetohet edhe nga Institucionet Certifikuese Përkatese.

Kjo kërkesë është krejtësisht favorizuese, ku AK i jep mundësi vetëm një OE-je të caktuar për nënshkrimin e kësaj kontrate me këtë kriter, sepse, sipas të dhënave nga ministria përkatëse, vërtetohet se aktualisht në Kosovë ekziston vetëm **një person** i certifikuar me këtë profil përkatësisht është vetëm një Gjeolog i Certifikuar si Ekspert nga MPMS/MFPT dhe janë 2 persona të Certifikuar për VNM nga MMPHI.

Nga lista zyrtare në faqen e ministrisë si të Certifikuar/Licencuar janë:

- Një (1) person i certifikuar si Ekspert i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë SSHP në Drejtimin e **Gjeologjisë dhe**
- **Dy (3) Persona të Licencuar pran MMPHI për VNM**

Vërejtje: Nga këta persona vetëm një posedon certifikim për Ekspert të SSHP dhe VNM.

Andaj, për të hapur tregun dhe për të rritur konkurrencën – si dhe për të siguruar çmime më të lira në treg – konsiderojmë se ky kriter duhet të ndryshohet.

Propozim për përmirësim: Një Gjeolog i certifikuar për VNM, me përvojë relevante edhe nga ana e Sigurisë dhe Shëndetit në punë. Kjo do të mbulonte në tërësi aktivitetin e prokurimit që AK ka shpallur, do të rriste konkurrencën dhe do të ulte nivelin e diskriminimit apo favorizimit të një kompanie të caktuar që ka të punësuar vetëm një person me këtë profil.

4. Pika 9.1 & 9.2 – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Pika 2.23: Një Magjistër i Shkencave Teknike në drejtimin Xehtari dhe Metalurgji

Dëshmitë: Diplomë, kontratë dhe certifikatë për ekspertizë në mbrojtje nga rrezatimi jonizues. Për të shmangur diskriminimin dhe favorizimin, konsiderojmë se AK duhet ta përmirësojë këtë kërkesë si vijon: Duke marrë parasysh faktin që sistemi arsimor në Kosovë dhe rajon është harmonizuar me Procesin e Bolonjës, termi “Magjistër i Shkencave Teknike” pas vitit 2002 kthehet në sistem / barazohet me **Master i Shkencave (MSc)** në drejtimet përkatëse teknike.

Propozim për formulim të përmirësuar: Magjistër i Shkencave Teknike ose Master i Shkencave Teknike në drejtimin Xehtari dhe Metalurgji.

5. Pika 9.1 & 9.2 – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Pika 2.25: Minimum (2) Ekspertë për mbrojtje nga zjarri, të certifikuar nga AME (Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave të Kosovës), të profilizuar në shkencat teknike për dhënien e shërbimeve sipas Udhëzimit Administrativ NR.10/2018. Stafi profesional duhet të përmbushë kapacitetin bazuar në ndarjen e faktorëve të rrezikut sipas Rregullores 02/2021, Rregullores 01/2021 dhe Udhëzimit Administrativ (MPB) nr.10/2018 – AME, për trajnimin fillestar në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe autoritetet e Ministrisë së Mjedisit.

Dëshmitë:

Diplomë universitare (kopje), kontrata e punës ose marrëveshjet për projektin konkret dhe certifikata nga AME, si dhe të jenë të certifikuar për Siguri dhe Shëndet në Punë nga MPMS.

Konsiderojmë se kjo kërkesë nuk është e qartë, sepse termi “**të profilizuar në shkencat teknike**” lë hapësirë vlerësim subjektiv te komisionit vlerësues dhe për trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Sqarim dhe pyetje për AK-në: AK duhet të specifikojë saktësisht **profilin e kërkuar të ekspertëve**, meqë përkufizimi “të profilizuar në shkencat teknike” është i paqartë dhe lë hapësirë për interpretim subjektiv gjatë vlerësimit. Sipas kornizës ligjore aktuale, ekspertët e certifikuar nga AME dhe MPMS mund të jenë të profilizuar në fusha të ndryshme – shkencat teknike, emergjenca, siguri dhe shëndet në punë – dhe të gjithë ndjekin trajnime të licencuara sipas udhëzimeve dhe rregulloreve përkatëse.

Pyetja jonë për AK: A mund të specifikoni qartë cilat drejtime apo fusha studimore përfshihen në termin “**shkenca teknike**”, dhe nëse përfshihen edhe ekspertët e profilizuar në fushën e emergjencave apo në drejtime të tjera relevante, të cilët janë të certifikuar nga AME ose MPMS dhe i përmbushin të gjitha kërkesat ligjore të përmendura më sipër, nëse nuk ka trajnime në projekt bazuar në specifikacionin teknik të DT, ju lutem cila është arsyeja objektive e vendosjes së këtij kriteri pasi që në bazë të informatave në Kosovë nga kompanitë e Licencuara e plotësojnë vetëm dy nga 16 kompani të Listuar në faqen zyrtare të Kompanive të Licencuara në Kosovë?

Prandaj, duke u bazuar në argumentet e lartshënuara, me respekt i kërkojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit që pas shqyrtimit të kësaj Ankese, të nxjerrë këtë:

VENDIM

- I. APPROVOHET në tërësi si e bazuar ankesa e operatorëve ekonomik MD Legal Consulting & Training Center SH.P.K.
- II. KORIGJOJ kriteret e dosjës së tenderit për aktivitetin aktivitetin e prokurimit me titull: “Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës në KEK sh.a”, Nr. i prokurimit: KEK-25-5008-2-1-1 dhe Nr. i brendshëm KEK-25-106-211.
- III. SHTYJË HAPJEN E OFERTAVE.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale të mundshme si pasojë e kësaj procedure mund të arrijnë vlerën deri në 300,000 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*